Biblioteka No. 3 ALBANIA 3

# KËNGËT SHQIPE NË MËRGIM

Përmbleth këngët Kombëtare dhe disa këngë Dashurie



KONSTANDR

ALBANIA
shtypankronjë, librëlidhje, kartonazhe, papeteri, stereotipi, fabrikë për shtampilla

Çmimi 25 Qind. arr

BKSH

# Këngët Shqipe

# NË MËRGIM

Përmbleth këngët Kombëtare
dhe disa këngë Dashurie

Botohet prej Shtypëshkronjës „ALBANIA"

KONSTANCE
Shtypur në Shtypëshkronjën „ALBANIA"
1916

ВКSH

# Parëthënie

## Të dashur këndonjës.

*Bëmë shtypëshkronjën Shqipëtare këtu në Konstancë që të mundim më lehtë të punojmë, do-me-thënë, të shtypim libra, gazeta ose ç'do gjë qoftë në gjuhën shqip.*

*Shohim që të pakë janë nga Shqipëtarët e këtushmë që u japin rëndësi libravet ose gazetavet po ne do vazhdojmë punën qoftë me shumë mundime.*

*Eshtë e treta libër që po shtypim në këtë shtypëshkronjë dhe shumë*

*libra janë për të shtypur posa që do përkujdesen Shqipëtarët të na ndihmojnë.*

*Me gjith që shumë prej këtyre këngëve janë shtypar, por sot janë të humbura, ose të burgosura, dhe ne dyke marë nër sy, se këngët ngjatlin një njeri ose një komp, edhe dyke marë nër sy lutjen e disa Shqipëtarëve sot shtypim librën* **Këngët Shqipe në Mërgim** *ku besoj që Shqipëtarët do të na ndihmojnë dyke blerë këtë librë që të nisim librat e tjera me radhë.*

Konstancë 13 Vjesht e I-rë

Juaj me besë
**M. PIRO**

# ARDHI KOHA

Ardhi koha e bekuar
Për Shqipëri të lëftojmë,
Mbretin t'onë t'a nderojmë,
Dhe të vdesim të gëzuar

O burra s'duhet kursyer
As gjaku as rrojtja t'onë
Port' e Qiellit duhet thyer
Ti vëmë fronë
Mbretit t'onë.

Edhe mëmat po na thonë
Përpiquni për Shqipërinë,
Për nder' e saj për lirinë
Vdisni dhe për mbretin t'onë

O burra s'duhet kursyer, etj.

Për liri për Mbretin t'onë
Tërë botën të çuditim,

Dhe ç'do dit duhet t'i ngjitim
Një vitore në kurorë.
O bura s'duhet kursyer
As gjaku as rojtja t'one
Port' e Qiellit duhet thyer
T'i vëmë frone
Mbretit t'onë

*Durrës 7 Mars 1914* *Loni Llogori*

---

## HYMNE MBI M. TE TIJ MBRETIT TE SHQIPERISE WILHELM I I

---

Jakëni o Shqipëtarë,
Qjithë bashk' e të pa ndarë
T'i falemi Perëndisë
Për jetën të Shqipërisë!
T'i falemi dit' e natë,
Zot' i math t'i jap' uratë!
Lëvdoni
Uroni
Mbërenë,
Të ketë
Për jetë
Shëndenë

Se e kemi mëm' e atë;
Pastë jetënë të gjatë.
Wilhelm, mbretn' e lëvduar
Mbretn' e nalt të Shqipërisë
Zotn' e math' të Zotërisë
Mbrojtësinë e Lirisë!
Lëvdoni e.t.j.
Wilhelm-i shum' i çkëlqyer
I dashuri Mbreti tonë
Prej Zotit qoft i bekuar
Thron' e lart t'a trashëgonjë
Ejani pra që të gjithë,
T'i falemi Perëndisë!
Lëvdoni
Uroni
Mbërenë
Të ketë
Për jetë
Shëndenë

Themelimi i kësaj vjershe është pas një vjershe që i dëgjuari vjershëtor i ndyeri N. H. Frasheri kish bërë per Sultanë Hamidnë dhe këndonëshe prej djemt e shkollës Shqipe në Korcë me një zë të bukur. Kthyer dhe shtuar tani prej Z. Th. Avrami mbi mbretin' e dashur tonë Wihelm' e I-rë dhe këndohet gjith me atë zë.

Nga Kal. Korça 1916.

## VJERSH' E VASO PASHES

(Dekun nē 1892)

Mori Shqipëni e mjera Shqipëni,
Kush të ka hudh me krye në hi?
Ti ke pas ken nji zonj' e gjân,
Qi burrat e dheut të qujshin nân.
Ke pas shum' të mira e shum' begati;
E vajza të bukra e djelm me trimni.
Gja e dhëna shum e ara vështina,
Me armë të lara me pushk lltina,
Me burra trima me gra të dlira,
Ti nër gjith shoqet ke kën mâ e mira!
Kur kriste pushka si shkrepëtin moti,
Zogu i Shqipëtarit gjithmon i zoti.
Ka pas ken nër lufta e në luft ka vdek
E dhuni për prapa kur nuk kish hek.
Kur ka pas lidh besën burri i Shqipnis
I ka p's shti dridhën gjith Rumelis,
Nër lufta të repta gjith mon ka rá,
Me faqe të bardh gjithmon âsht dâ,
Ene s'të ka met as fam as bes,
Vet e ke prish me faqet të-zes.
Ju Shqipëtar' me vllazën jini tui vra,
E n' nj' qint çeta jini shpërda.

Ca thon kena fe, ca thon kena din,
Njani thot jam turk tjetri llatin,
Do quhet grek, shqe disa të tjer,
Po jeni vllazën gjith, mor të mjer.
Prifnit e hoxhët ju kan hutu,
Për me ju damun e me ju vorfënu.
Vjen njeri i huj e ju ri në votër,
Për me ju turpnu me gru e me motër.
Për ca pare të shkreta qi do fitoni,
Besën e të parve të gjith e haroni.
Ene bahi robt e njeriut të huj,
Qi nuk ka as gjuhën as gjakun tuj.

Qani ju shpata, qani ju dyfeqe,
Se u zu Shqipënia si zogu nër leqe.
Të qaj trimnia të qaj bashkë me ne,
Se ra Shqipnia me faqe në dhe.
Ene si ka metun as buk as mish,
As zjarm në votër as drit as pish.
As gjak nër faqe as ner nër shok,
Por âsht rëzumun âsht bamun trok.

Mblidhuni ju vajza, mblidhuni ju gra,
Me ato sy të bukur që dini me qa,
Ene të vajtoni Shqipënin e mjer,
Qi ka met e shkretë pa emën e pa ner,

Qi ka net e vej si grua pa hur,
Si nâna qi nuk ka bamun fëmi kurr.
Kujt i ban zemra me lan ne vdek,
Këtë far trimneshet që sod âsht mek.
Këtë nân të dashmë as po dot e lam.
Qi njeriu i huj t'a shkeli me kâm?
Nuk, nuk këtë marrëni kurkush s'e do,
Këtë faqe të zez kurkush s'e duro.
Para se të humi kështu Shqipënija,
Me pushk në dor le të vdes irimnija.
Çohni Shqiptar pri gjumit çohni,
Të gjith si vllazën n'nji bes shtërgohi.
Ene mos shikoni kisha e xhamira,
Se feja e Shqiptarit âsht Shqiptarnija.
Qy pri Tivarit deri në Prevez,
Gjith kun ku lëshon dilli vap e rrez.
Asht toka jon plaçet na i kan lan.
Kush mos na e përkas se vdesim të tan,
Se vdesim si burrat qi vdiqin që motit,
Për mos me u turpënu para zotit.

---

## SHKRONJAT T'ONA

Që kur dolli shkronja jonë
Të pakë njerës mësojnë;

Të shumët hiqen më nj'anë,
Thonë jemi grekomanë.

Punënë të kotë' e kanë,
Që s'duan vëllazërinë
Të huajt duan t'i mbajnë,
T'a mohojnë Shqipërinë.

Shqipëria dot' ndërtohet,
Shumë do të zbukurohet;
Me shumë gjëra të mira,
Me mejtep' e me skolira!

S'duam shkronjat me gërqisht,
As i duam me tyrqisht!
Ter' Evropa latinisht,
Dhe Shqiptari latinisht.

J. Hila.

---

## BETIMI MI FLAMUR

*Hymn Patriotik*

Reth Flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith atij duk' ju betuar
Të lidhin besën për shpëtim,

Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur trathëtor
Kush është burrë nuk' frikohet
Po vdes, po vdes si një dëshmor

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mprojmë atdhenë më ç'do kënt,
Të drejtat t'ona ne s'i ndajmë;
Këtu armiqtë s'kanë vënt.

Se Zoti vetë e tha me gojë
Që Kombe shuhen përmi dhe
Po Shqipëria do të rojë;
Për 'të, për 'të luftojmë ne!

O flâmur, flamur shënj e shënjtë
Të ty betohemi këtu,
Për Shqipëria' atdhen' e shtrënjtë
Për nder' edhe lavdia' e tû.

Trim burrë qobet dhe nderohet
Atdheut kush i-u bë therror;
Për jet' ay do të kujtohet
Mi dhet, mi dhet si një shëntor!

Nga libra „Endra e Lotë"

## KENGA E SHOQERISE VELLAZERIA

(Pas Këngës: W.e ein stolzer Adler)

Sot gjith djalëria
Ç'është kah po pret?
Sot vëllazëria
Ne po na thëret
Shpejt, o djalëri
Dita ka harri!

Ne vëllezër jemi,
Ne askush s'na lot
Gjith një gjuhë kemi
S'munt t'na ndajnë dot.
Shpejt o djalëri
Dita ka harri!

Vllezër qem e jemi
S'kemi për t'u ndar;
Bes' e fe ne kemi
Kombin Shqipëtar!
Shpejt o djalëri
Dita ka harri!

Djem të Gegërisë,
Lidhni-u tok me ne!

Djem të Toskërisë,
Eni bëni be!
Shpejt, o djalëri
Dita ka harri!

Tjatër nuk duam
Bes' e dashuri;
Gjithë u betuam
Krofsh vëllazëri!
Krofsh o djalëri,
Lule për Shqipëri.

*Sulioti*

## UNË USHTAR DO VETE

Unë ushtar do vete
Për ndimn' e mëmëdheut,
Me shpatënë në dorë,
S'i madhi Skëndërbeu.

Të lë shëndenë,
Se un do shkonj
Në luft do vete,
Për ty do lëftonj.

Ja tek të le ilamurë
Për t'iminë kujtim,
Dhe n'mos u kthefsha prapë,
Atë ta kesh për gëzim.

Ti Zotit fali-u
Të përparonj,
Të kthehem prapë,
Ty të të gëzonj!

Ti mos ki keq moj nënë
Se un këtu më s'rri,
Po me pushkën' në dorë
Mu në Shqipëri do vi.

Të le shëndenë etj.
Ti zotit fali-u etj.

*E popullit*

## O TRIMA LUFTETARE

O trima luftëtarë
O bijt e Skëndërbeut
Kërkoni Shqipëtarë
Lirin' e mëmëdheut

Se mjaft në robëri
Voj e mjera Shqipëri!
O djem rembeni pushkat
A vdekje, a liri!

Sot lypset me flamurë
Malit të dalimë,
I ër mbi shkëmbinj e gurë
Liri të ngjallimë.

Se mjaft në robëri
Voj e mjera, etj.

S'ju ren o shok kjo jetë?
S'ju ren kjo robëri?
Qysh e duroni vetë
Shqipërinë pa liri.

Se mjaft në robëri, etj.

Ju mbetët nënë zgjedhë,
Kur bota lulëzon;
Po Shqipëria e mjerë
Zemra s'ja u kujtoni

Se mjaft në robëri, etj.

*Thanas Fteqi*

## S'PASKA SI SHQIPERIA

Kur ika lashë Shqipërinë;
Kur lashë prapa Korçënë:
Ata male, atë lëndinë,
Ku humbet njeriu mëndjenë.
Kur zunë pyllet të fshihëshin,
Dhe zoqtë më s'dëgjohëshin,
Atehere lotët' më ranë,
Dhe sy e zemër të dy qanë.
Qani, qani syt' e mia,
Se s'paska si Shqipëria!

Pashë Morenë, Italinë;
Shëtita Franc' e Gjermaninë;
Barita tërë Bullgarinë,
Po s'pashë no-një bukurie
Ndë tër' këto gjeta mburim
Po i Çardhakut s'ka rëfim.
Barita fushën të Rusisë;
Të Rumanisë, të Sërbisë;
Pashë malet të Helvetisë,
Po s'paska si të Shqipërisë!

*Lasi Legori*

## KU KEMI LERE ?

Në ç'vënd kemi lerë ?
Ku na bëjnë nderë?
Në Shqipëri.

Po njëriu vetë
Cilnë do në jetë?
Do vend' e ti.

Ku i duket balta
Me ëmbël se mjalta?
Në Shqipëri

Ku ron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë ?
Në vënd' të ti

Ku munt të gëzojë?
Dhe me nder të rrojë?
Në Shqipëri.

Për se të punojë
Dhe të lakëmojë?
Për vend' e t/.

A. Z. Cajup

## ME THËRET NDERI

Më thëret nderi të pregatitem
Që për në luftë me vrap të shkonj,
Nat' edhe ditë dotë përpiqem
Sa të jem gjall me nder të ronj.

Pa më jep lejën o mëma ime,
Se mua nderi po më kërkon;
Se mjaft u mbusha me hidhërime
Sa të jem gjall me nder të ronj.

Pa më jep armët o mëm' e dashur,
Se kërcet pushka topi gjëmon;
Si ndohem unë të kisha plasur
Sa të jem gjall me nder të rronj.

Se ngriti krye gjith Shqipëria
Dhe as një orë s'dua të ronj:
U mblodhë gjithë si mizëria
Sa të jem gjall me nder të ronj.

*E popullit*

## VDEKJA E SKENDERBEUT

Nga na vjen tinë
Trim o kapedan?
Vinj nga ushtëria
Nga mali Ballkan.

A e njeh tinë
Trim o kapedan
Mbretn' e Shqipërisë,
Skëndërbe me nam?

Un e njoh fort mirë,
Bashkë jam përpjekur
Dhe për Shqipërinë
Trim' i mir ka vdekur!

Armikun ç' e hëngri!
Në këmbë s'e la!
Gjer në buz të varit
Skëndërbeu s'ju nda.

E Popullit

## LUL' E BUKUR

Lul' e bukur po si djell
Kush të mbolli ty këtu?
Më ka mbjell im Zot nga qjelli
Për të ndritur mënt e tu.

Lum' ay njeri i urtë.
Që më sheh e më mbeson!
Vet vetiu un' s'kam mbirë,
Lum ay që kupëton!

I pa besi le të thotë,
Që kam mbirë prej vetiu,
Edhe bukurinë t'ime
Fisi verbërë e mbiu.

Ç'do njeri është i kotë
Që s'njeh kryetar e ti,
Dhe shkon jetënë të zezë
Pa shpresë, gjithë në zi!

Mua Zoti më ka mbjellë
Çdo i urt' e kupëton,
Le të msonjë çdo i pjellë
Një mësim që të lartonl

D. N. Mala

## ARDHI DITA

Ardhi koha, ardhi dita
Iku nata dolli drita;
Ngrihi djema mos përtoni
Këtë punë t'a mbaroni
S'është mjaft sa ju duruat)
Edhe tër' ato që vuat ? )2

Eshtë turp për emrin tuaj
Të mundohi për të huaj!
Qitni pallën si ju dini
Edhe kordhën në e kini.
Me gjit zemër e pa ndjesë]
Bini qenit të pa besë ]2

Mjaft me robënë të çjerë
Mproni vatrën, mproni nderë!
C'mbani duart si të thata ?
Nxirni hata edhe shpata!
Ferat gjëmbat t'i qëroni ]
Lule që të mbijn në doni ]2

Për trima ju trima ini;
Këtë dhe ju vet' e dini:
Po ç'dobi esht për atdhenë

Kur s'ësht ashtu si kur ka qënë!
Shqipërinë ju n'e doni
Nga ky rezik ta shpëtoni } 2

Kryet ngrihni, z gjedhën shtini
Pastaj lumtur që të jini!
Ju në jini atdhetarë
Dhe të thjeshtë Shqipëtarë.
Bëni-e ju sot atdhenë,
Siç qe nënë Skënderbenë } 2

ASDREN

---

## KUSHTRIMI

Pas kènges: va fouri d' Italia.

---

Sot gjithë o burra!
Le t'çohet delmnija!
Sot gjakun si gurra
Ta derdhin Shqypnija!

Shpejt djem te flamuri
Me tuba të ngasim,
Se Leka e Burri
Na thrasin sot me vdek!

Nër male vraponi
E ngani nër prita!
Anmikun dëboni,
Se ardhi sot dita,
Qi jasht na të qesim
Barbarin prej shpijet!
Si bura të vdesim
Atdhen me e liru.

Me shpata të shdesh'na
Ta msyjm na anmikun!
T'i ngulim ner t'ndeshn'a
N'trup t'tyne çelikun!
N' mauzer' e martinë
Armumun t'a ngasim!
Nër t'vetat e shkretina
Barbarin t'a dëbojm!

E Populit

## DITURIA

O vëllezër Shqipëtarë
Lidhuni ndë dashuri;
Erdhi koha, e mësimit,
Të fitojmë dituri.

Mos mënoni, mos mënoni
Punën tuaj mos haroni
Epni sot me dorën plot
Ndë mos mbjelçi s'korni dot.

O vëllezër, pa dëgjoni
Kohën mos humbasim kot
Dituri ndë mos fitofshi
Puna jonë vête kot.
Mos mënoni, mos mënoni etj.

Rok mësimnë mos e lerë,
Ruaje se të larton;
Mirësi ka për të bërë,
Ëdhe jetën t'a gëzon,
Mos mënoni, mos mënoni etj.

Dituri! sa fjal e bukur!
Lum ay që e fiton;
Më ç'do pun' e më ç'do fjalë,
Mëmëdhenë, e nderon.
Mos mënoni, mos mënoni etj.

QIRIAZI

# KOMITI

Lamtumir ju le shëndenë
S' ardhi ora që të skonj
Për liri për mëmëdhenë
Me gas vete të lëftonj.

Gjer mos fitojmë lirinë
Komit kam unë me vdekur
S' duronj dot më robërinë
Se mjaft zëmrën ma ka djegur.

Pushka m'është mëm' e dashur
Edhe shpata e çkëlqyer
Ati im këto ka hasur
Me gjak të armikut lyer.

Shtëpi kam gunën e dhirë
Malet pyjet ku jetonj
Dyke pritur nat e ditë
Armiknë t'a copëtonj.

Se reh bora shiu e breshëri
Këjo rojtje s'më tmeron
Se esht' e ëmbël si sheqeri
Kush për Shqipëri lëfton

Vdekja kurrë s' më tremp mua
Si ç'do tjatërë njeri
Se vdekjen e kemi hua
Po lum kush vdes për liri.

Kal. „Korca" 1910

M. G.

## MEMEDNEU

Mëmëdheu im i dashur
Të Fala nga lark dërgonj:
Për ty qanj, për ty përpiqem
Dhe nga zëmra dëshëronj.

Oh, oh moj Perëndi
Le të të vinjë keq!
Gjer kur në robëri
Kombi ynë po heq?

Nga gjiri yt un se ç'u ndashë
Dhe se ç'ardha në mërgim!
I huaj në vënt të huaj,
Nga malli më zu lëngim

Nga një baltë dhe ne

Nuk na gatove ti,
Për se të jemi robër
Të mos kemi liri ?

Zotit të vërtet i falem
Nde u kthefsha përsëri,
Të të gjenj zonjë të madhe
Si ç'ishnje moj Shqipëri.

Përpiquni dhe vetë
Pa-dhe unë t'u ndih
Mos thoni dyke ndënjur,
Shpëtona Perëndi.

Se ç'm'u sos durimi nënë
Lotë po më venë det!
Më s'e mbanj dot ngashërimnë:
Nëno, mbeçë me shëndet.

Mos e pandeh, moj nënë
Se unë këtu më s'do rri!
Po me pushkë në dorë
Do dal në Shqipëri.

Nëna jonë nënë zgjedhë
Se ç'po heq ç'po psherëtin,

Neve shoqi-shoqit themi,
Ti je turk un jam elin

Botën e liruam,
I dham edhe liri,
Po nënën t'on, o shokë,
E kemi në rob' ri.

L. V. Laskua

***

Stim: Qani qani o syt e mia,
Se s'paska si Shqipërira!
O Shqipëri, o Shqipëri!
O burra djem; përpiquni.

E Popullit.

---

## ALLFABETI SHQIP

---

Sot ësht dita, Shqipëtarë,
Të përpiqemi,
Allfabetin t'on t'a mbrojmë
Shpejto burani!
Skronjat t'ona jan' të arta,
Këto duamë.

Shqipëri atdhe i dashur !
Ne s'të lemë ty të varfër
Skronjat t'on' i kem për të mprojtur
Me gjith shpirt Sqipëtarisht.

Armikët o Shqipëtarë
Po përpiqenë
Shkronjat turçe dhe gërqishte
Të na apënë;
Le t'i mbajn' ata për velite,
Kemi t'onaitë.

Shqipëri, atdhe i dashur. etj.

Ata duan, Shqipëtarë,
Ndarjenë t'onë,
Këtë punë shum kthiellt
E treguanë.
Ngrihuni pra t'u tregoni,
Se ju s'i ndroni!

Shqipëri, atdhe i dashur. etj.

P. Qirias

## MEM' E DASHUR

O Zoti im, o Perëndi,
Shtjer syt' e Tu shikomë Ti!
Për se më le të shkretë sot?
E mjera vdes dhe s'duronj dot.

O mëmëzë, e dashurë,
Ç'na je kështu e ç'pate ti?
Përse na je helmuarë?
Përse na qan e na mban zi?

Se bijt e mi dhe bijatë
S'më duan më, as kanë mall;
Gjith kush kërkon të tijatë,
Më lan' e vdes në këtë hall.

O mëmëzë ne bëmë faj,
Po fal-na-e se paskëtaj
Të gjithë ne që sheh me sy
Do të përpiqemi për ty.

Na me pahir po rronj un sot
Njeri s'më flet, se s'më sheh dot
Ndër shoqe s'dal jam shumë keq
Nga bijt' e mi gjith këto heq

O mëmëzë, ne bëmë faj, etj.

Me lot ndër sy thëres e qanj
Për dit rënkonj dhe zi po mbaaj;
Gjithkush punon, për vehte sjton,
Po mua sot kush më kujton?

O mëmëzë, ne bëmë faj, etj.

Ndë t'erëtë pa dritë jam,
Gjëkund mbi dhet un shoqe s'kam:
E çveshur dhe e xbathur jam,
Me kaqe bij sikur s'i kam.

O mëmëzë, ne bëmë faj, etj.

Kujt i erth keq e kusiy më pa
E mjera vdes se s'kam ç'të ha,
Po qysh të vdes me kaqë djem?
Këtë mendim kam turp ta them.

O mëmëzë, në bëmë faj, etj.

Ndë vdekça un këtë u them:
Do t'vuani o bij o djem!
Sa do e varfër që të jem.
Ndë siguri un munt t'u kem.

O mëmëzë, në bëmë faj, etj.

O Perëndi, as më dëgjo!

Të arthtë keq e më kujto!
Për vehte gjë unë s'kërkonj
Po djemt' e mij dua t'i msonj.

O mëmëzë, ne bëmë faj etj.

Gj. D. Qirias

---

## KANGE LUFTE

O ti e mprehta, o palla ime,
Dhe ti i flakti dyfeku im!
Të gjith armiqtë bëni thërime,
Dhe përvëloni bëni hi,
Që të lirohet gjith Shqipëria,
Në shesh të dalë trimëria!

Se për lirinë t'mëmëdheut t'im,
Edhe të gjuhës shkrim e këndim:
Për k'to të dyja do të ïëftonj,
Ojer sa të dyja do t'i fitonj!
Këto të dyja po mos fitonj,
Mua ç'më ïypset më që të ronj?

Ora ardhi, trumbetat bien,
E për në lufte gjaku më zien,

Anë dhe mb'anë po bje buria,
Topi e pushka ja po kërcet;
Me trimëri lefton djalëria,
Gjithë po vdesin për mëmëdhet.

E popullit

---

## HYMN MBRETENOR

O Mbret i dashtun ynë
O Mbret i Shqypënisë,
Me besa-besën Tynë
Për mprojten e lirisë
Të gjith të vijmë pas
Si burra plot me gas;
Për Shqypënin' e shtrënjtë
Për Flamurin e shënjtë!

Rreth burra ke Shqyptarë
Stërnipt' e Kastriotit;
Mbret, kâmbën patsh të mbarë
Dhe ndihmën e Tën-Zotit.
Kudo që vafsh fitim
Për një të math qëllim;
Ku âsht gjuha jon' e fara
Shpjer flamurin përpara.

Sa malet rofsh t'urojmë
Si do deshira jonë;
Nderimet t'i dërgojmë
Nga zemra përgjithmonë.
Për Ty sot bëjmë bë
Për Flamur për Atdhe
Me besë të t'shërbejmë
Dhe gjakun mos kursejmë!

O Perëndia jonë
Të lusim dit' e natë,
Beko-na Atdhen e Fronë
Dhe jet' u fal të gjatë.
Në veprat trimëri
Plot nder e plot lavdi
Fatbardhë që të jemi
Sa jetë që të kemi!

Asdren

---

## URATE PER LIRI

Mer uratën bir prej maje
Edhe armët i gatit,
Se erth dita e shënuar
Dolli ylli e na ndrit.

Është ylli i lirisë,
Me të tjerë nuku ngjet;
Shqipëria kaqë shumë
Këtë yll që po e pret.

Djemt' e saj le t'a dëftejnë
Kush mban emër Shqipëtar,
Që s'ka kurë me duruar
T'a urdhrenjë një barbar.

Vdekje djema të kërkoni
Për të shëujtëne liri,
Se rojtjen përse e doni
Nëuë zgjedh' e robëri ?

Rojtja pa nder është vdekje
Po një vdekj' e pa mbuluar,
E kur vdes për mëmëdhenë
Je i gjall' i pa haruar.

Të gëzuar atëhere,
Kur për juve do të msojnë
Që për mëmëdhën' u vratë
Me kënge do t'u mbulojnë.

E do shkruajnë mi var,
që ju vdiqtë për lirinë

Pranë flamurit të kuq
E nderuatë Shqipërinë.

A të kthyerë nga lufta
Burërisht, ose plagosur,
Nënat tuaj me gas shumë
U kanë për të qafosur.

E kurorë trëndafilta
Për mi krye do t'u ngjeshin,
Edhe emrat do t'u rojnë
Kurë, kurë do mos vdesin.

Andaj bir pa ndarë dua
Përmi armët të betosh;
Që i vdekur a i gjallë
Kthe nashti të .ë nderosh!

Si i dha uratën djalit,
Mori armët e betoj:
«Për lirin' e Shqipërisë
(Tha) do vdes» e flytyroj.

Nga Kenget Shqipe - M. Gramenos

## KENG' E GJERGJ KASTRIOTIT

Tërë Gegëria, se çpo qan me lot;
Gjergji Kastrioti na ka vdekur sot!

Atdhe, o i dashur atdhe!
Eja më vajto, se mua më smë ke!

Tërë burrat, se ç'po qajn me lot:
Gjergji Kastrioti na ka vdekur sot!

Atdhe, o i dashur, etj.

Tërë trimat sot jan' në zi kah mbajn:
Gjergji Kastriotin me lot po e qajn!

Atdhe, o i dashur, etj.

Tërë Shqi ëri a u-mblodhë një xan,
Gjergji Kastrioti dolli në mejdan!

Atdhe o i dashur atdhe
Eja të më ndjeksh se mua sot më ke

Tërë djemuria sot në luftë po nget,
Gjergji Kastrioti sot në Lesh po i pret

Atdhe o i dashur, etj.

E popullit

## ELBASAN QYTET I BUKUR

Elbasan qytet i bukur,
Në kërthiz të Shqipënis,
Bijt' e tu o po si flutur
Rokin librat e dituris.

Dallandushe bukurosine,
Më thuaj nji her nji fjal;
Ku je nis e ku do shkoshe
N' ato lumna me shum val ?

Po të munt të fluturojë
E t'i kishe krah't si ti,
Me gëzim të math do shkojë
Shqypënis brênda në gji.

Duke shkamun anës lumit,
Elbasan e ne Tiran;
Ne ke ti do vi, moj Skodër,
Të shof Drinin e Bujan.

Ju malet e Shqypnisë
Ene ju lisat e gjat,
Kodra, male, fush' e pyje;
Nër mënt ju kam dit' e nat.

O pëllumb ti krahëshkrumun,

Sa do ndëje ti pa pun,
Fluturo dyke nxitumun
Zgjo ata qi jan në gjum!

Korç, o Korç, Korçë lule,
Shoqet t'uja ç'i le pas!
Si trimi me pall ç'u sule!
Na për jet t'a paçim hu!

O ti Zot i gjithësisë,
Epi sot liri Shqypnis!
S'të vjen keq, o Perëndijë,
Se dh'ajo ka bir e bijë?

E popullit

---

## PËR MËMEDHENË

(Kënga e kryengritësve Sqipëtarë).

---

Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë
Vraponi burra, se s'ka me prit!
Të vdesim sot ne me besa besë
Pranë flamurit të-kuq q'u ngrit!

Pranë flamurit, pranë flamurit
Me shpatën xveshur shqipëtarisht,
Për dhen' e Babës edhe të Burrit

Kemi me vdekur sot burrërisht.

Tym edhe flakë, ujë të-valë
Baba Tomori nxjer e buçet,
Të gjithë trimat atje me dalë,
Se dita erdhi koha më spret !

E Drini plaku me oshëtima
Mbi Shqipërinë valët po derth;
Tosk' edhe Gegë si vetëtima
Armikut bini se dita erth;

Ejani burra malit përpjetë
Dyke beluar vdekj' a liri;
Se s'ka m'e-ëmblë në këtë jetë,
Kur vdes Shqiptari për Shqipëri !

Shpatat gatitni e të përzejmë
Armikn' e egër nga memëdheu,
Se afroj dita, që t'i dëftejmë,
Që kemi lerë nga Skënderbeu !

Vdekje, vëllezër, ne të kërkojmë
Se sa një jetë në robëri
Më mir një ditë neve të rojmë,
Po zgjedhjen shkundur e në liri.

Poshtë rob'ria, posht' errësira

Qe po përndorin armikët sot!
Njeni me kisha tjatri xhamira;
Jemi vëllezër s'na ndajnë dot!

Nga Plagët M. Grameno

## SA TE RONJE GJITHESIA

Sa të ronjë gjithësia
Sa të ronjë gjithë dheu,
Do të ronjë Shqipërija
Edhe emr' i mëmëdheut!

Nëno ty të le shëndenë
Se shoknia po më pret!
Falmë nëno pak bekimnë
Se trumbeta po thërret.

Se detyr' e djalërisë
Eshtë luïta për atdhe,
Për nderë të Shqipërisë
Dëshmimtar vete të vdes!

Kol Tromar

## TE FUNDARIT ÇPEJTO

Puno gjer sa është ditë,
Se nata po t'afron;
Dita si një kalorës
Ecën edhe shkon.

Djelli duke ndriçuar,
Nxiton edhe punon;
Dhe duke bekuar,
Udhën e mbaron.

Puno dhe ti gëzuar,
Vapën e duro;
Dhe pas këtij mundimi
Ri e u gëzo.

Nxito gjer sa ke kohë —
Punën t'a mbaronç;
Pa ardur edhe nata,
Të mos dëshëronç.

Puno gjer është ditë
Se nata po t'afron;
S'ka atëhere punë,
Djelli nuk ndriçon.

E POPULLIT

## MBRET I FUQIVET

O Zot, Ti fuqimath
Ndihna ne tashi
Të lutemi;
Lavdi të t'apëmë
Me gjithë zemërë;
Për dashurimnë t'ënt
Që shohëmë.

O Zoti yn tashti,
Eja sot përsëri
Të lutemi;
Fuqi Ti na dërgo,
Ndihmë të jet ajo,
Se shpresa j'on është
Vetëm ne Ty.

O Zot, Ti fuqimath
Bekona ne tani
Të lutemi;
O Perëndi na ep
Gjithë të miratë,
Të kemi mall të math
Për mëmëdhe!

O Zot, Ti na beko!
Nën krahun tënt na shko
Të gjithë ne!
Ne do betohemi,
Të gjith për Perëndi,
Edhe do vdesimë
Për Shqipëri.

Gjakun do derdhimë
Për mëmëdhetinë
Të gjithë tok.
Lavdi të t'apiunë
Me gjithë zemërë
Për dashurinnë Tënt,
Që shohëmë.

E populit.

## KENGA E SHOQERISE DESHIRE NE SOFJE

Që më një të Kollozhegut
U fillua shoqëria;
U fillua brënda mu në Sofje
Për skoli ndë Shqipëri.

Burra, o burra djema! )2
Burra djem, burra djem, përpiquni)

Koh' e sotm' o Shqiptarë,
Eshtë shumë e pëlqyer;
Eshrë vërtet shumë e pëlqyer!
Mblidhuni ndë dashuri.

Burra, o burra djema, etj.

Zot' i math, të qofshim falë,
Që s'na le në errësirë,
Po na fale në mest tënë
Një të madhe dashuri!

Burra, o burra djema etj.

S'jemi Grekër, as Bullgarë,
Tyrq, as Sërbë nuku jemi!
Jemi vetëm Shqipëtarë
Këtë emër nder e kemi.

Burra, o burra djema! )2
Burra djem, burra djem, përpiquni)

E popullit

## DETETAR

Detëtar, o trim i ndjerë
Nga-e lundrën drejt për drejt,
Që t'arijmë sa më shpejt
Nd'atë vënt ku un jam lerë!

Syri lotë më pikon
Esht mjaft kohë larg që jam;
Veç në ty un shpresë kam
Të gjenj paqen q'më mungon!

Detëtar o djal' i mbarë
Mos vono të qofsha fal'
Nga-e lundrën që të dal'
Atje tek jeshe më parë!

Deti sa-do q'ësht i gjerë
Bashk' me ti nuk më tmeron'
Ti trim je e më shpëton
Dhe për këtë ti je bërë!

Hai! o burra detëtarë!
Sa m'pëlqen, sa më gëzon
Kur shkel lundra, kur flut'ron
E më shtyn ku un kam zjarë!

Asdren

## KENG' E SHOQERISE „YLL' I MENGJEZIT"

Yll' i mëngjezit unë jam,
Ndë Kollozheg lindurë kam,
Me një qëllim fort të lartërë
Që më sjell kohë të artë:
O zonja atdhetarka ju
Dhe ju vraponi gjithë kështu!
Të gjitha tok përpiquni,
Që të na sillni mbrodhësi!

Shqipëria po pret edhe nga ne
Të gëzonemi të ngjallemi,
Të marëm pjesë për atdhe!
Ejani Zonja, shpejtoni!
Me zemër e duar punoni!
Motrat nga padla t'i çoni!
Shpirtin me die t'u-a ndritoni!
Mëndjen u-a lartoni!
Ejani, ejani më shpejt!
Më shpejt, se koha spret!

Detyrë fort të rëndë ka
Ç'do e ndrituarë grua,
Të përpiqetë mos mbetetë.
Nga dia më pas se buratë

Zoti na ka falurë dhe ne
Si të tyrenë një mëndje;
Pra mblidhuni të gjitha sot!
Mos thoni: Presimë gjer mot!
Shqipëria pret edhe nga ne, etj.

P. Qirias

---

## HIMN I BANDES SE LIRISE

Muzik' e Z De Pascale Annibale

Male e fusha ushtojnë sot,
Zër' i atdheut po ndëgjohet:
Dita po nisë ngadal e zbardhohet,
Ndritë si qe një mot.
Humbur s'e kemi jo shpresën,
Ditë të bardha kujtojmë
Ejani vëllezër në këtë çast besën
Ne për atdhen t'a forcojm!

Besën t'a lidhinë tok me ne
Djemët të rrept të Shqipërisë
Kjo është Banda e yn e Lirisë,
Është një yll për atdhe!
Këngën nga herë e kemi,
Lidhjenë t'onë t'a shtojmë;
Të tërë vëllezër ne kjem e dotë jemi,
Vdesim e nuku do ndrojm.

Korçe VIII 19 Sakoll

---

## KUSHTRIMI

«La Marseillaise» e Shqipërisë

Përpara djem të Shqipërisë!
Zëri i kushtrimit po gjëmon!
Kundrë nesh i mizorisë
I ndyri flamur po valon,
I ndyri flamur po valon!
Malet Tona po ushtojnë
Nga bërtimet e Nizamit:
Egërsirat ju kërkojnë
Nder' e gruas, gjakn' e djalit!

Burra, kush është trim,
Në luftë me nxitim!
Me hov, me hov! bini me tërbim
Armikut për ç'përbliml

Ç'kanë me ne këta barbarë,
Shtaza në shpirt e në turi?
Hapni syt', o Shqipëtarë
Shikoni hekurat gati!
Qafën kujt duan t'i vënë
Nënë zgjedhë, nënë kërbaç?
O turp i tmerrshëm, i pa thënë,
Shkabë t'a ngasin si margaç?

Burra, kush është trim, etj.

Topi buçet, pushkat pështyjnë
Plagë dhe Plumb, vdekje dhe zjarr!
Trumbetat ndizen edhe çfryjnë!
Yt fat po lozet komb shqipëtar,
Që nga Janina gjer në Shkodrë,
Burë dhe grua, foshnjë dhe plak,
Ç'do lum' e prua, ç'do shesh e [kodrë
Po rjedhin lot po rjedhin gjak,

Burra, kush është trim, etj.

Dridhuni ujq të Mongolisë,
Dhe ju Shqiptarë për mallkim
Që çponi syt' e Shqipërisë
Ah dridhuni, se s'ka shpëtim!
Ah dridhuni, se s'ka shpëtim!
Ç'do krah do ngrihet të ju bjerë
Dhe këta trima po të mbeten.
Vënd'ynë pjell trima të tjerë
Gati të ngrihen të ju derdhen!

Burra, kush është trim, etj.

E shëndjetë flag' e atdheut,
Zemrat na ndiz me trimëri?

Kujtim' i math i Skënder Beut,
Ndihna në luftë për liri,
Ndihna në luftë për liri ?
Armiqtë tanë t'i rëzojmë
T'u ngulim këmbën në krahruar,
Dhe, kur shpirt japin dhe lëngojnë,
Të shohin Krujën e çliruar!

Burra, kush është trim, etj.

Djema, në fushë kur të shkojmë,
Nuk do t'i gjejmë pleqtë t'anë;
Kockat e tyre do t'dëshmojmë
Si lëftuan dhe si ranë.
Vepra e tyre do t'na ndezë
Me laft të vdesim si ata,
Ndë qell të kuq shkabë e zezë
Dyke e ngjitur la e më la!

Burra, kush është trim, etj.

Faik Konica

## DITT' E DJALERISE

Ditt e djalërisë jan për të kujtuar,
Kohën kur e shkonim gjith me gëzim
Lodrat' e pafajmë s'jan për të haruar
Zembrat tona plot me dëfrim.

Pyj të dëndur, fush' të gjera
Edhe sot un smunt ti haronj ti haronj
Mal' edhe shpes të gjitha bashkë,
Prap nga zemra i dëshëronj.

Jet e djalërisë, e së lumtërisë
Ahl që s'u-haronj dot un sa të rronj
Ku je ti, o kohë, koh' e bukurisë!
Pse kështu me krah fluturon?
Pyj të dëndur etj.

Oh kjo jet' e shkuar' është për të
[dëshruar
Po si lul e verës kur lulëzon,
Emr' i Zotit t' ënë qoft' i lavdëruar,
Se edhe tashi na gëzon.
Pyj të dëndur etj.

Gj. D. QIRIAS

## KËNG E MOTIT RI

Zotërinj dhe Zonja arthmë t'ju
[gëzojmë,
Edhe këtë motnë neve t'ju këndojmë.
Kjo dit e bekuar edhe plot dëfrime
Mot i ri n'a solli, mbushur me gëzime
Sot çdo shpresë lindet ngjallet për-
[sëritet
Edhe fat i bukur nga kjo dit po pritet
Këtë mot që skojti ne le t'a harojmë,
Edhe motn e ri tani le t'a vështrojmë
Duket se ka ardhur, nga një udh' të
[gjatë
Andaj është i lodhur, po është' i begatë
Duart i ka mbushur plot me ç'do
[dhuratë,
Misardhe, misardhe, o mot i begatë.

Kal. „Korça" 1910

Thanas Fleqi

# KENGE DASHURIE

## DRENOVARJA

(Mi ere të „Le Petite Tocqueloise")

Një dit shkova
Nga Drenova,
Gjeta një vajzë të re:
Ish e bukur, ish e mitur,
Duket ishte fort e ngjitur,
Dhe më thotë
Me zë plotë:
„Zot që më vë kaqë re,
Ne do udhënë të gjesh,
Aj me mua dhe mos qesh!

*(Ref.)* Jam i lodhur, thashë fare!
Moj Drenovë, moj Drenova, moj
[Drenovare!
Rimë pakë mi lëndinë,
Të flasim për dashurinë:

Se ti zemrënë ma more!
Moj malëso, moj malëso, moj malë-
[sore!

Me këtë bukuri që ke,
Më bëre udhën të le!
Ndënjimë pranë
Dhe mënjanë,
Më shtinte nga një vështim,
Unë me sy ment e hanja,
Doçkën ndë timet ja mbanja,
Kur më thotë
Me zë plotë:
„Në më do me nder si trim,
Tek im'atë aj të vesh;
Më kërko dhe ty më keshë.
(Ref.) Jam i lodhur, thashë fare etj.

Ah! të dua,
Dhe për grua,
Dua thashë, të të kem,
Sa do rojmë të gëzuar,
Kur do jemi të martuar,
Dhe për jetë,
Me vërtetë,
Unë për ty do të jem:
Tek yt' atë këtë ças

Do të vete që t'i flas.
(Ref.) Jam i lodhur thashë fare etj.

E kërkova
Dh' u martova,
Tashi kemi pesë vjet
Që po rojmë të gëzuar,
Dhe zoti na ka dhuruar
Dy fëmijë
Bir e bijë
Si ëngjëj dhe plot shëndet;
Dhe sa herë i shëkonj
Këtë këngë do kujtonj:

(Ref). Jam i lodhur, etj.

L. LOGORI.

---

## DASHURIA ESHT DJALLUSH

Mi erë, L' amur est us petit gamin"

---

Dashuria ësht' djallush,
Heth në prush
Cili-kush
Do kuxonjë t'a trazonjë
Mjer ay që kërkon nga puna ta nda-
ſlonjë

Mer shigjetën edhe e vret,
As e pyet
Si një mbret
Që do gjithë t'a dëgjojnë,
Plag e ti s'mbyllet shpejt dhe barat
[se shërojnë
(Ref). Kur vjen beari dhe qershitë,
Vajzat e bukura,
Faqet pa-puthurara,
Andej këtej kërkojnë miqtë,
Duan të lozinë,
Të qeshinë.
Zemrat hapen atë çast,
Dhe me gas
I nagas
Dashurinë të këndojnë,
Vajza, djem gjithë tok dhe buzët të
[bashkojnë.
Gjoks çelur kundërmon,
Dëshëron
Dhe kërkon
Të puthet me dashurinë,
Jashtë do të dalë se mënt e pëlcet
[gjinë.
(Ref) kur vjen beari, etj.

L. Logori

## SA BUKUR RONIME

Sa bukur rronimë
Kur ishim bashkë!
Dashurin' e kishimë
Të ëmbël shumë
Zili na kishinë
Të gjithë bota,
Kur na shëkoninë
Bashkë të dy.

Tani që u larguamë,
Po dëshërojmë,
Syt me lot ngarkuamë,
jetën shkutuamë,
Gjer, sa të vinjë
Ora e mirë,
Që të të shoh,
Pa le të vdes!

Të dua, të dua, të dua
Gjer në buzë të varritë,
Edhe të vdekur,
Edhe të vdekur,
Une s'të le!

Spiro I. Tasi

## SYT' E TU

Syt' e tu bukur kulluar,
Zemra mua gjith më breth
Që të munt për të fituar
Të bëhem kusar t'i vjeth,

Në qoftë se më gjykojnë
Edhe mua kan për t'më mvarr,
Nuk do vdesë, po do rojnë
Një i lumtur kusar.

Të dërgova për kujtimnë
Trëndafilin që më dhe:
Nukë di a do t'a njohësh,
Prej kaqë kohë që s'e pe.

I.L. BIMBLI

## CELU! CELU!

[Mi erë të «La Spagnola»]

Mos u helmo që do ikinj
Se zemrën t'ime t'a le,
Prej teje s'munt të më çqitinj,
Veç vdekja mi këtë dhe.
Syr' i zi yt më ka i lhur,

Dhe sado lark që të jem
Në zëmrë të rosh e ndritur;
Në mëndje tynë do kem.

Çelu, çelu! mos ri sëndisurë!
Ti je lindur për dashurië;
Mos e hump atë bukurië!
Celu, çelu! Mos ri sëndisurë!
Syt e tu mos lëshojne lot,
Zemra ime si duron dot.

Bilbili këndon mëngjezë,
Dhe unë tynë këndonj.
Luletë kërkojnë vesë,
Dhe unë tynë kërkonj
Kur djelli puth trëndafillë,
Dhe çelet ndrit zbukuron;
U kam zili dhe bilbilë,
Pa ty, ah! s'munt t'a dëgjonj!
Çelu, çelu etj. (Ref).

L. LOGORI

## MALLSORJA

Ti moj pëllumbesh' e malit,
Pse nuk qasesh afër zallit,
Të shtrëngoj na kraht' e mi,
Të të bënj dashurinë,
T'harosh nënë dhe shtëpinë,
Mos kujtosh as Perëndinë,
As Perëndinë.

[Ref.] S't'uloth dora dyke tjerur
Dhe shtëllungën dyke mçjellur ?
Hidhe furkën atje tej
Edhe qasu më këtej,
Që të zgjedhish lule-kuqe
Unë buzët burbuqe.
Moj faqe-kuqe!

Në lulishte pranë zallit,
Aj dhe ti moj lul' e malit,
Të ja shtojmë bukurinë,
Të këndojmë dashurinë
Buzët bashkë t'i shtrëngojmë,
Kupidon t'a adhurojmë,
T'a adhurojmë!

(Ref.] S'tu loth dora, etj.

D. BERATI

## MUAJ I MAJIT

Sa i hëmbël ish muaj i Majit!
Kur dilnimë rëzesë malit,
Pranë burimit rinim qëndronim
A e mban mënt sa bukur rronim?

Nën' ata lisa të lulëzuar
Losnin bilbilat dyke kënduar
Të përqafosur rinim dëgjonim
A e mban mënt sa bukur ronim?

Të vdisnim atëhere sa mirë qe,
Në krah tënde kur bënje be,
E dyke puthur tinë më theshnje
Q'jetën pa mua nuk e deshnje.

Të vinjë prapë muaj i Majit,
Të dalim rëzësë malit,
Pranë burimit ne të qëndrojmë,
E zëmrat t'ona ne ti bashkojmë.

Nga „Plaget" M. G

## TRENDAFIL I BUKUR SHUME

Trëndafil i bukur shumë,
Mbret i lulevet ti je!
Errësirë m'është bota
Kur zotrote nukë je.

Gjithë ahë e gjithë vahë;
Tërë jetën në mërgim,
Njëzet vjetsh ç'më bëre plak
Un kur qanj ti ke gëzim.

Roj ti çupë, rroj ti vetë,
Pa dhe unë le të vdes;
Ç'do t'a dua rojtjen time
Une vetëm kur te mbes?

E popullit



BKSH

# ALBANIA

Konstanta (Rumanj)

Str. Traian 16-20

Telefon 83-1

SHTYPESHKRONJE
LIBRA-LIDJE
KARTONAZHE
STEREOTIPI
PAPETERI

Punon me një mjeshtëri të madhe dhe me një çmim fort unjët, gjithë send që u përkasin këtyr mjeshterive.

Kemi në depozit gjithë sendet që mban një Papeteri (Librari) e mbaruar.

PROVONI DHE DO TË SHIKONI

Administrata

ВКSH

ВКЭН

ВКSH